

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO
AGENCIA PËR TËRHEQJEN E KËRSHIT
AGENCIA PËR TËRHEQJEN E KËRSHIT
ANTICORRUPTION AGENCY

Dep. **DPK/DMP** Nr. Prot. **03-1872/13**
 Dep. **02** Nr. Prot. **14.06.2013**
 Nr. Itaq. **02**
 Dregjistrimi **02**
 Nr. pages

ANTI KORBUR

KA.nr.577/2013

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Biljana Rexhiq, kryetare e kolegjit, Dalip Bega dhe Ragip Namani anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Sebahate Hoti, duke vendosur sipas ankesës të ushtruar nga e pandehura Elizabeta Tara, nga Prizreni, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore Divizioni për Kundërvajtje në Prizren, Regj. nr.487-05/12, të dt. 25.01.2013 në bazë të nenit 17, par. 1. 3. të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më 16.05.2013 **bie këtë:**

AKTVENDIM

Ankesa e ushtruar është e **BAZUAR**

ABROGOHET aktvendimi i goditur dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në plotësim të procedurës dhe rivendosje.

Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve.

Arsyetim

Gjykata Themelore Divizioni - për Kundërvajtje në Prizren, me aktvendimin Regj.nr. 487-05/12, të dt.25.01.2013, e ka shpallë përgjegjëse të pandehurën Elizabeta Tara, nga Prizreni, sepse e njëjta në Kuvendin komunal ne Prizren, nuk ka bere deklarimin e pasurisë ne afatin e rregullt ligjor deri me date 31.03.2012, deklarimi i cili i obligon te gjithë zyrtaret e lart publik qe pasurin e tyre ta deklarojnë rregullisht për çdo vit, sipas kërkesës se AAK-nuk ka përmbushur këtë obligim ligjor brenda afatit.-Me te cilin veprim ka kryer kundërvajtjen nga neni 5,6 par.1.3 dhe nenin 9 te Ligjit nr.04/L-050, për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe dhuratave te zyrtareve te larte publik, dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për te gjithë personat zyrtar sanksionuar ne baze te nenit 17 par.1.3 te Ligjit te lart cekur.

Për këtë vepër kundërvajtëse e pandehura është dënuar me gjobë me shumë prej 250 €, dhe është obliguar që gjobën e shqiptuar ta paguaj ne afat prej 15 dite, nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktvendimi ne te kundërtën do ti zëvendësohet me dënim burgimi duke e llogaritur 15 euro me një dite burg, po ashtu e pandehura obligohet qe ne afatin e lartcekur të paguaj 5 €, ne emër te paushallit gjyqësor, nen kërcënim te ekzekutimit te dhunshëm.

Kundër këtij aktvendimi ankesa ka ushtruar e pandehura për shkak te:

- Të shkeljes thelbësore te dispozitave te LMK,
- Të vërtetimit të gabuar dhe jo te plotë të gjendjes faktike dhe
- Të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale

Me propozim që Gjykata e Apelit, aktvendimin e goditur ta prish dhe lëndën tia kthej gjykatës së shkallës së parë për plotësim procedure.

Kolegji i kësaj gjykate, pasi vlerësoi thëniet ankesës së paraqitur, aktvendimin e goditur, deklarimin e dhënë të pandehurës Elizabeta Tara, në seancën e shqyrtimit kryesore në procesverbal të dt.05.07.2012, deklaratat e dëshmitarëve Ibrahim Krasniqi, Samir Hoxha dhe Enis Sadiku, shkresat tjera të kësaj lendeje ka gjetur se:

Ankesa e paraqitur është e bazuar.

Kolegji i kësaj gjykate vlerëson se dispozitivi i aktvendimit të ankimuar është në kundërshtim me kërkesën e organit kompetent. E pandehura shpallet fajtores për mos deklarim të pasurisë në afatin e rregullt ligjor gjerë më 31.03.2012, ndërsa kërkesa e organit kompetent, ia vënë në barrë të pandehurës veprimin inkriminues për mos deklarim të pasurisë sipas kërkesës së organit kompetent, me rastin e marrjes së detyrës së zyrtarit të lartë publik, ndëshkuar sipas nenit 17 par.1 pika 3 të Ligjit mbi deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik, dhe deklarimin, prejardhja dhe kontrolli i dhuratave për të gjithë personat zyrtar. Për këtë arsye aktvendimi i atakuar nuk mund të qëndroj dhe është abroguar që në plotësim të procedurës, gjykata e shkallës së parë duke vepruar bazuar në vrenjtet e lartcekura, ti eliminoj kundërthëniet në mes të kërkesës së organit kompetent dhe aktvendimit të nxjerr, duke vërtetuar saktësisht se për cilën kundërvajtje përgjigjet e pandehura,. Pa s kësaj duhet të nxjerr aktvendim të ri dhe të bazuar në ligj.

Më sa u tha më lartë konform nenit 222 të Ligjit mbi kundërvajtjet u vendos si në dispozitiv.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

Ka. Nr.577/2013 të dt. 16.05.2013.

**Bashkëpunëtorja profesionale
Sebahate Hoti**

**KRYETARI I KOLEGJIT,
Bijana Rexhiqi**